



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:081494

Datë: 01.07.2022

Numri i dokumentit: 03193998

PKR Nr. 151/21

NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**, Kryetari i trupit gjykues Murat Hulaj dhe anëtarët e trupit gjykues, gjyqtarët profesionist, Nushe Kukaj Mekaj dhe Arben Mustafaj, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Alan Taranish, në çështjen penale kundër të pandehurit L L nga fsh., K. D., me dyshimin e bazuar mirë se ka kryer veprën penale, *“Vrasje e mbetur në tentative në rrethana të tejkalimit të mbrojtjes së nevojshme”*, nga neni 172 e lidhur me nenin 28 dhe nenin 12 par. 3, të KPRK-së, dhe veprën penale, *“mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së*, dhe kundër të pandehurit A N nga fsh., K.P., me dyshimin e bazuar mirë, se ka kryer veprën penale, *“Sulm”*, nga neni 184 par. 1, të KPRK-së, e duke vepruar sipas aktakuzës së PTH në Pejë – Departamenti i Krimeve të Rënda, nën shenjen PP/I Nr. 90/21 dt. 20.09.2021, e pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me dt.28.02.2022, dhe përfundimit të shqyrtimit kryesor me dt. 28.04.2022, nën prezencën e Prokurores së Shtetit, Lumturije Vuçetaj, të pandehurit: L L dhe A N, si dhe mbrojtësit e tyre, Taulant Broqi dhe Dritëro Kollçaku me autorizime, me dt.29.04.2022, morri dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 24.06.2022 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

***Të pandehurit:***

1. **A N**, nga i ati Q dhe e ëma D e gjinisë S, i lindur me dt. në fsh. R, K. P., me vendbanim në rr. nr. në P., i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, veteran i luftës, i identifikuar me nr. personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i dënuar edhe më parë me aktgjykimet P.nr. 833/09 dhe P.nr. 458/10, gjendet në liri.
2. **L L**, nga i ati L dhe e ëma F e gjinisë H, i lindur me dt. në D, me vendbanim në rr. “” fsh. C, K. D., i pamartuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar me nr. personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë nën masën e paraburgimit nga dt. 06.05.2021 e gjerë me dt. 29.04.2022, gjendet në liri,

**JANË FAJTOR**

## Për shkak së:

### I. I pandehuri A N

Me dt. 24.03.2021, rreth orës 22:25, në rr. “P.K”, K. P., pikërisht përballë firmës “SHPK A.” – ish depo e stacionit të trenit, me dashje përdor forcën ndaj personit tjetër, në atë mënyrë që, pas një konflikti verbal e të atëçastshëm ndërmjet tij dhe të dëmtuarit L L, i njëjti fton këtë të fundit që të sqarohen, ashtu që i pandehuri L afrohet tek automjeti “ ”, ngjyrë metalike, me targa:, pronë e të pandehurit A që ishte ndalur dhe parkuar skaj rrugës, ky i fundit del nga vetura nga ana e shoferit dhe pas shkëmbimit të disa fjalëve, e godet me kokë dhe me të dy duart e shtyn të dëmtuarin L, i cili tërhiqet në një distancë rreth tri - katër metra prapa, e që pastaj pasojnë veprimet e përshkruara si në dispozitivin II.a,

- me çka ka kryer veprën penale “**Sulmi**”, nga neni 184, par. 1, të KPRK-së.

### II. I pandehuri L L

- Me dt. 24.03.2021, rreth orës 22:25, në rr. “P.K”, K. P., pikërisht përballë firmës “SHPK A.” – ish depo e stacionit të trenit, në rrethana të tejkalimit të mbrojtjes së nevojshme tenton ta privojë nga jeta personin tjetër, në atë mënyrë që, pas një konflikti verbal e të atëçastshëm në mes të pandehurit dhe të dëmtuarit A N., siç është përshkruar në dispozitivin I, i pandehuri tërhiqet në një distancë rreth tri - katër metra prapa, ndërsa që më pas i dëmtuari A dhe dëshmitarët B Cj dhe E N nisen në drejtim të të pandehurit L, në atë moment ky i fundit nga çanta e tij e krahut nxjerr revolen e të tipit ”Z.”, kalibër ..., me nr. serik: ...dhe me të njëjtën, nga një distancë afërsisht dy metra, shtie njëherë në drejtim të të dëmtuarit A N, duke e goditur atë në pjesën e barkut dhe duke i shkaktuar kështu lëndime të rënda trupore, për çka më pastaj ka pranuar dhe ende gjendet nën tretman të vazhdueshëm mjekësor,

- me çka ka kryer veprën penale “**Vrasja në tentativë në rrethana të tejkalimit të mbrojtjes së nevojshme**”, nga neni 172, lidhur me nenin 28 dhe 12, par. 3, të KPRK-së.

- Më parë ka siguruar e gjerë me dt. 06.05.2021, rreth orës 14:00, në shtëpinë e tij në fsh. C, K. D., në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët, mban në pronësi armë, në atë mënyrë që, pas incidentit të dt. 24.03.2021, rreth orës 22:25, të përshkruar si në dispozitivët paraprak, ishte arratisur gjer me dt. 06.05.2021, kur edhe ishte dorëzuar pranë policisë dhe ndër të tjera kishte dorëzuar edhe armën e përdorur ditën kritike, e që pas konfiskimit ka rezultuar të jetë një (1) pistoletë të llojit “Z.”, kalibër 6.35mm, me nr. serik: ..., me një (1) karikator me dy (2) fishekë, kalibër 6.35mm, me mbishkrimin ..., të cilën e kishte vendosur në ulësen e prapme të automjetit V.G, ngjyrë e zezë, me targa: ..-...-., që edhe e kishte drejtuar deri tek rrethrotullimi tek “U.”, rruga që shpie për në D., vendi ku edhe ishte dorëzuar, e për të cilën armë nuk posedonte leje përkatëse,

- me çka ka kryer veprën penale “**Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve**”, nga neni 366, par. 1, të KPRK-së.

Andaj në aplikim të nenit 7, 8 par. 1, 17, 21, 38, 39 par.1 nën par. 1.1 dhe 1.3, 40 par. 1 pika 1.2 dhe pika 1.3, 69 par.1, pika 3.6 dhe 3.7, 70 par.1 pika 2.2, 2.7, 2.13 dhe nenit 184 par.1, 172 lidhur me nenin 28 dhe 12, par. 3, 366, par. 1, të KPRK-së, si dhe nenit, 360, 365, 366, 450 par. 1 dhe par. 2 pika 2.6 dhe 463 par.1 dhe 2, të KPPRK-së:

## G J Y K O N

- I. Të pandehurin **A N** për veprën penale nga dispozitivi **I** të këtij Aktgjykimi me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muajsh, e i cili dënim ka për tu ekzekutuar në afat prej 15(pesëmbëdhjetëditësh ), pasi qe aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm.
- II. Të pandehurin **L L** për veprën penale nga dispozitivi **II-a** me dënim burgimi prej 3 (tri) vite dhe gjashtë (6) muaj, të cilin dënim i njëjti ka për ta mbajtur pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, e ne të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe atë nga dt. 06.05.2021 e deri me dt. 29.04.2022.
- III. Të pandehurin **L L** për veprën penale nga dispozitivi **III** të këtij aktgjykimi me dënim me gjobë në shumë prej 1000 (një mijë) euro, të cilën gjobe i njëjti ka për tu paguar në afat prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi ta merr formën e prere.
- IV. Nëse i pandehuri, dështon apo refuzon ta paguaje dënimin me gjobë, i njëjti do ti zëvendësohet ne dënim burgimi duke i llogaritur një dite burgimi shumen prej 20 euro.
- V. Obligohet i pandehuri **L L** në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor në shumën e përgjithshme prej 50 (pesëdhjete) euro si dhe në paguarjen e taksës për kompensimin e viktimave të krimit në shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro
- VI. I pandehuri **A N** lirohet nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale dhe taksës për viktimat e krimit pasi që është veteran i luftës.
- VII. Konformë nenit 367 par. 1 pika 1.2 të KPPRK-së të pandehurit **L L** i ndërprehet masa e paraburgimit pas shpalljes se këtij aktgjykimi.
- VIII. Konformë nenit 366, par. 3, të KPPRK-së, ndaj të pandehurit **LL**, shqiptohet

## DËNIMI PLOTËSUES – MARRJA E SENDIT/KONFISKIMI

**KONFISKOHET Një (1) pistoletë "Z.", kalibër ..., me nr. serik: ..., me një (1) karikator dhe dy (2) copë fishekë, kalibër 6.35mm, me mbishkrimin ...;**

**URDHËROHET Një (1) pistoletë "Z.", kalibër ..., me nr. serik: ..., me një (1) karikator dhe dy (2) copë fishekë, kalibër ..mm, me mbishkrimin ..., dhe te njëjtit pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të shkatërrohen.**

- IX. Palët e dëmtuara, reciprokisht, për realizimin e kërkesave eventuale pasurore juridike udhëzohen ne kontest të rregullt civil.

X. E të gjitha këto në afat prej 30 ditësh, pasi që ky aktgjykim ta merr formën e prere.

### **Arsyetim**

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Krimeve të Rënda me dt. 20.09.2021 ka ngritur aktakuzën nën shenjën PP/I Nr. 90/21 kundër të pandehurve L L nga fsh. C, K. D., me dyshimin e bazuar mirë se ka kryer veprën penale “Vrasje e mbetur në tentative në rrethana të tejkalimit të mbrojtjes së nevojshme” nga neni 172 e lidhur me nenin 28 dhe nenin 12 par. 3 të KPRK-së dhe veprën penale “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së dhe kundër të pandehurit A N me dyshimin e bazuar mirë se ka kryer veprën penale “Sulm” nga neni 184 par. 1 të KPRK-së.

### **Shqyrtimi fillestar**

Gjykata me dt. 01.10.2021, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në këtë çështje penale në prezencën e Prokurorit të Shtetit, të pandehurve L L dhe A N si dhe mbrojtësve të tyre, av. Taulant Broqi dhe av. Dritëro Kollçaku të dytë të angazhuar sipas autorizimit.

Në seancën e shqyrtimit fillestar pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, i pandehuri L L ka deklaruar se e pranon fajësinë për të dy vepra penale për të cilat akuzohet me aktakuze, ndërsa i pandehuri A N ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë, për veprën penale për të cilën akuzohet.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit L L gjykata ka marrë mendimin edhe palëve ne procedure, me ç’rast mbrojtësi i të pandehurit, L L, av. Taulant Broqi, është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tij, mirëpo Prokurori i Shtetit dhe mbrojtësi i të pandehurit A N kane deklaruar se nuk pajtohen me pranimin e fajësisë, nga ana e të pandehurit L L, për shkak se kemi të bëjmë me prova të përbashkëta dhe se veprimet inkriminuese të tij, kane lidhshmëri me përkrahimin e diapoizivit që e ngarkon të pandehurin A N.

Pas kësaj, kryetari i trupit gjykues ka marrë aktvendim procedural me të cilin ka refuzuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit L L dhe po ashtu ka udhëzuar palët që kanë të drejte që në afat prej 30 ditësh ta paraqesin kundërshtimin e provave, kërkesën për hedhje të aktakuzës si dhe propozime tjera eventuale.

### **Kërkesa për hedhje të aktakuzës**

Mbrojtësi i të pandehurit, A N, av. D K, në afat ligjor, me dt. 08.10.2021 ka parashtruar kërkesë për hedhjen e aktakuzës për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri A N ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në aktakuze.

Prokurori i Shtetit me parashtrësën e datës 07.12.2021, ka dhënë përgjigje në kërkesën për hedhje të aktakuzës duke potencuar se kërkesa për hedhje të aktakuzës është tërësisht e pabazuar pasi që nga provat e siguruara është provuar saktë dhe çartë gjendja faktike e përkrahur si në aktakuzë dhe se ne veprimet e të pandehurit A N, qëndrojnë të gjitha elementet e figurës së veprës penale, “Sulm”, nga neni 184 par. 1, të KPRK-së, dhe po ashtu i ka propozuar gjykatës që kërkesën për hudhje të aktakuzës ta hedh poshtë si të pabazuar.

Pas kësaj, gjykata me dt. 16.12.2021, ka marrë Aktvendim, me të cilin ka refuzuar kërkesën e mbrojtësit të të pandehurit A N, av. D K, si të pabazuar me arsyetimin se Prokurori i Shtetit me provat që janë pjesë e shkresave të lëndës ka vërtetuar dyshimin e bazuar mirë, se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

### **Shqyrtimi kryesor**

Gjykata me dt. 04.02.2022, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor në të cilën kanë qenë prezentë Prokurori i Shtetit nga PTH në Pejë, i pandehuri L L, së bashku me mbrojtësin e tij, av. Taulant Broqi, sipas autorizimit dhe i pandehuri AN së bashku me mbrojtësin e tij, av. Dritëro Kollçaku sipas autorizimit.

Në fillim të seancës së shqyrtimit kryesor, e pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, të pandehurve prapë i është dhënë mundësia që të deklarohen në lidhje me fajësinë apo pafajësinë, ashtu që i pandehuri L L, ka pranuar fajësinë për veprat penale të cilat i vihen në barrë, ndërsa i pandehuri A N nuk ka pranuar fajësinë, për veprën penale për të cilën akuzohet.

Pas kësaj, dhe pas marrjes së mendimit të palëve në procedurë, trupi gjykues ka marrë aktvendim me të cilin ka refuzuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit L L.

Pas kësaj seanca e shqyrtimit kryesor është shtyre për shkak se nuk ka pasur kushte për vazhdimin e seancës, meqenëse Prokurorja e Shtetit ka deklaruar se nuk është e gatshme që të lëshohet në shqyrtim pasi që nuk është aktakuza e saj dhe se ka nevojë që të përgatitet pasi që sot e ka pranuar nga shkrimorja penale e prokurorisë e duke shtuar se bartësi i kësaj lëndë ishte Prokurori tani në këto ditë ka shkuar në pension.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor gjyqësor me dt. 28.02.2022, e cila ka filluar rishtazi pasi që janë ndërruar dy anëtare të trupit gjykues.

Në fillim të seancës së shqyrtimit kryesor, e pas konstatimit si të lexuar të aktakuzës nën shenjen PP/I Nr. 90/21, nga ana e Prokurorit të Shtetit, të pandehurve prapë i është dhënë mundësia që të deklarohen në lidhje me fajësinë apo pafajësinë, ashtu që i pandehuri L L ka pranuar fajësinë për veprat penale të cilat i vihen në barrë, ndërsa i pandehuri A N nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Trupi gjykues pas marrjes së mendimit nga ana e palëve në procedurë ka marrë Aktvendim me të cilin ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit L L për veprat penale nga dispozitivi II të aktakuzës, pika a dhe b, dhe atë për veprat penale “Vrasje e mbetur në tentative në rrethana të tejkalimit të mbrojtjes së nevojshme” nga neni 172 e lidhur me nenin 28 dhe nenin 12 par. 3 të KPRK-së dhe veprën penale “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, ndërsa meqenëse i pandehuri A N nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, gjykata ka vazhduar me shqyrtimin gjyqësor dhe me dhënien e fjalës hyrëse në drejtim të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri A N.

### **Fjalët hyrëse**

Prokurorja e Shtetit në fjalën hyrëse ka deklaruar se: gjate këtij shqyrtimi gjyqësor në raport me të pandehurin A N për veprën penale që i vihet në bare do të dëgjohen dëshmitarët B C, M

L, L B dhe E N nga të cilët do të vërtetohet se i pandehuri AN ditën kritike ka kryer veprën penale për të cilën është paraqitur duke përdor forcën fizike ne raport me të pandehurin L L. Ne administrimin e provave tjera, dhe incizimit të siguruar nga vendi i ngjarjes do të vërtetohet se ditën kritike këtu i pandehuri A ka sulmuar fillimisht të pandehurin L L me çka edhe me mbrojtjen e të pandehurin do të vërtetohet se i njëjti ka konsumuar elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar.

Mbrojtësi i te pandehurit A N, av. Dritëro Kollçaku ne fjalën hyrëse deklaroi: Nga provat materiale qe do të administrohen, nga dëgjimi i dëshmitareve e sidomos nga video incizimet te marrura nga kamera e sigurisë do te vërtetohet dhe ky trup gjykues do të bindet se ne veprimet e të mbrojturit tim nuk ka ekzistuar asnjë element i veprës penale Sulm.

I pandehuri A N është pajtuar me fjalën hyrëse qe ka paraqitur avokati i tij dhe mbështet deklarinimin e tij.

Pas dhënies së fjalës hyrese gjykata ka vazhduar me administrimin e provave personale.

#### Administrimi i provave personale

Në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me dt. 28.02.2022, gjykata ka dëgjuar dëshmitaren **M L** e cila ka deklaruar se: Ditën kritike kemi qene te stacioni i trenit, furra Diaspora me L dhe me dëshmitaren tjetër L, kemi mare për të ngrënë dhe jemi nisur për banese, pa mbërritur te banesa, erdhi një xhip i hint me xhamat e zi, vetura është ndaluar përderisa ne kemi qene duke ecur, xhamin e veturës kane qelur pak ka ana e pasagjerit, dhe i kane thënë L nga makina “a po na jep një neve se i paske dy”, ne qato momente kerri shkoi ne drejtim të rrethit dhe prapë është kthyer ne krahun tjetër te rrugës, ne ndërkohe ne kemi qene ne afërsi të tunelit për të hyre në banese kur ai e parkoi makinën, ne atë moment e ka hapur derën e shoferit dhe e ka thirr L dhe i ka thënë “o ti kopil” apo diçka të tille, dhe i ka thënë se “hajde se kam pune me ty” L ne ndërkohe me ka jap do qese dhe ka shkuar te kerri, dhe kur ka mbërritur të kerri L, shoferi i ka ra me kry L dhe kanë dalur edhe dy djemtë tjerë nga kerri. Ne atë momente L është zbraps pak nga frika, ne atë moment që të tre janë shkuar ne drejtim të tij, ne atë moment L i ka gjuajt me armë dhe derisa isha te tuneli ngjarjen e kam pa dhe e kam vërejtur ne tërësi. Pastaj unë jam ik ne banese, L është ik dhe më nuk kam pa çka ka ndodh. Tutje ka deklaruar se personi që ka goditur L ka qene shoferi i veturës i cili më pas është i plagosur nga L. Po ashtu shton se është e vërtetë që tre persona kanë nisur në drejtim të L në momentin kritik, dhe se dy të tjerë kane dalur nga vetura dhe Li ka qene midis tyre, në një moment ka qene i rrethuar dhe është tërhequr, në atë moment që është tërheq ka gjuajt. Në lidhje me bisedën mes të pandehurit L dhe të pandehurit A e njëjta ka deklaruar se herën e pare automjeti ka qenë në lëvizje, ndërsa pasi që janë kthyer kanë parkuar kerrin, është hapur dera e shoferit ndërsa vetura ka qene e parkuar trup, dhe në atë moment e kanë thirrur L dhe i kanë thënë se “hajde se kam punë me ty”. Tutje ka deklaruar se distanca mes saj dhe tyre ka qene afër aq me pas mundësi me degju bisedën e tyre, ndërsa kur është goditur me kokë L nuk është rrezuar por është tërhequr, dhe se ajo dhe dëshmitarja tjetër kane pasur mundësi që ta shohin krejt ngjarjen, dhe se ajo personalisht e ka parë ngjarjen derisa është rrezuar personi i cili është plagosur.

Në këtë seance të shqyrtimit kryesor të dt. 28.02.2022 është dëgjuar dëshmitarja **L B** e cila ndër të tjera ka deklaruar se natën kritike ka qene me M të furra të rrethi të hoteli J, aty janë takuar me L, ndërsa pas kësaj ka ardhur një xhip i cili e ka ngucë përderisa ishin duke lëvizur, dhe nuk është e sigurte a e kanë shajtë ose i kanë thënë L “ama njonen”. Tutje ka deklaruar se në xhip kane qene tre persona dhe ata kane vazhduar mirëpo janë kthyer në rreth, kanë parkuar

veturën në krahun e djathtë dhe e kanë thirrur L duke i thënë “hajde këtu”, dhe kur ka shkuar L e kanë kapur për gjoks dhe e kanë goditur me kokë, e ka vërejtur kur shoferi e ka kapur për gjoks L dhe janë konfrontuar mes veti, dy persona të tjerë po ashtu kanë dalur nga vetura dhe ajo e ka pa L tu terhek dhe në atë moment e ka dëgjuar edhe një krismë. Tutje shton se personat në veturë një herë kanë shkuar por prapë janë kthyer dhe e kanë thirrur L cili ka shkuar që ta bisedoje me ta, ndërsa për dëshmitaren M deklaroi se e njëjta ka ikur por që nuk e din në cilin moment, ajo personalisht ka qene aty afër ngjarjes dhe më pas ka ikur edhe vet në banesë ndërsa sqaron se L me rastin kur ka shtënë është larguar për afërsisht 4-5 metra. Tutje ka deklaruar se në momentin kur ata tre persona kanë dalur nga vetura e ka vërejtur që kanë shkuar në drejtimin e tij, ndërsa nuk din saktë sa ka qene afërsia mes tyre kur është dëgjuar krismë. Ne momentin kur ka takuar dëshmitaren M kjo e fundit i kishte thënë se nuk ka pa ngjarjen por vetëm ka dëgjuar krismën, mirëpo shton se M ka qene se bashku me ta kur është kthyer vetura në rreth rrotullim dhe është hap dritarja dhe është ftu L që të shkoje të personat të cilët e kanë thirrur dhe sqaron se nuk mund të dije sakte a ka qene M me ta në momentin kur është godit L, vetëm e din se ajo personalisht e ka parë ngjarjen.

Në këtë seance po ashtu është dëgjuar dëshmitari **B C** i cili ka deklaruar se: Natën kritike ka qenë se bashku me A dhe E me xhip dhe veturën ka qene duke drejtuar A. Deklaroi se ka pasur xhamin e hapur pasi që ka qenë duke pirë duhan dhe ka qenë në ulësen e pasagjerit. Atë natë kanë frekuentuar rrugën tek hoteli J. Ata kanë qene duke shkuar në drejtim të rrethit prej rrugës për P.C në drejtim të rrugës për Prishtinë dhe para se të shkojnë të rrethi e kanë dëgjuar një sharje nga një djalë i cili ka qenë me një vajze. Tutje shton se ne Prokurori ka deklaruar se ky djali ka qene me dy vajza dhe se kjo është e vërteta. Tutje deklaroi se nuk kanë vazhduar rrugën por janë kthyer dhe e kanë pyetur atë djalin se pse po shan dhe se A i ka thënë se nuk bën që të shahen njerëzit kështu, dhe A nuk i ka thënë asgjë më. Ne momentin kur ka dalur nga vetura A edhe ata dy kanë dalur nga vetura, I ballafaquar me deklaratën e dhënë në Prokurori i njëjti deklaroi se është e vërtetë që ka deklaruar se A e ka shtyrë L. I njëjti po ashtu deklaroi se në momentin kur kanë dalur nga vetura distanca mes tyre ka qene shume afër, ndërsa ne momentin kur L është tërhequr dhe ka gjuajtur ata kanë qene duke dashur të hyjnë në veturë dhe ne momentin kur A është qëlluar ai është rrëzuar ne durt e tij. Po ashtu shton se ne momentin kur kanë ndaluar veturën nuk e kanë thirrur L por ai ka ardhur vet.

Në këtë seance është dëgjuar edhe dëshmitari **E N** i cili fillimisht është njoftuar me të drejtat e tij dhe dispozitën e nenin 127 par. 1 pika 1.2 për dëshmitarin e privilegjuar pasi që të pandehurin e ka prind, mirëpo i njëjti deklaroi se dëshiron të deklarohe në lidhje me çështjen. I njëjti në lidhje me rastin ka deklaruar se: natën kritike ka qenë me A dhe BC me një xhip. Deklaroi se kanë qenë te hoteli J dhe kanë parë djalin me dy vajza, ai e ka pasur xhamin e veturës të hapur dhe kur kanë kaluar afër tij i njëjti e ka shajtë, ata janë kthyer në rreth dhe e kanë pyetur të njëjtin se pse po na shan dhe ai ka shajtë prapë, kur ka dalur A nga xhipi L ka ardhur në drejtim të tij, A prapë e ka pyetur se pse po shan dhe i ka thënë shko të shtëpia dhe mos shaj njerëzit pa të bo asgjë. Ai djali pastaj është larguar dhe ka gjuajtur, ndërsa në atë moment ai dhe dëshmitari B kanë qene duke dal nga xhipi. Ne momentin kur A e ka shtyre L sqaron se kanë qenë jashtë veturës që të tre. I njëjti sqaron se A e ka kapur për dorë L në momentin kur është afruar të dera e shoferit por nuk e ka pa që A e ka godit L me kokë, me L nuk kanë pasur probleme me herët, mirëpo deklaroi se ka dëgjuar në veturë kur ka shajtur dikush, mirëpo nuk e din arsyjen e sharjes pasi që kanë qenë duke bërë hajgare mes veti. Shton se A e ka dëgjuar i pari sharjen dhe kanë qene duke shkuar në shtëpi por janë kthyer që ta kuptojnë se pse ai person e ka shajtur dhe kur janë kthyer, deklaroi se A nuk e ka thirr atë personin por ai është afruar menjëherë pasi që A përmes xhamit të cilën e kishte të hapur e ka pyetur se pse po shan. Në momentin kur ai u afrua te vetura, A ka dal dhe sërish e ka pyetur se

pse po na shan, pastaj e ka kap për duart dhe e ka qu pas veturës, dhe sqaron se ne momentin kur e ka kapur për duart edhe e ka shtyre.

### Administrimi i provave formale - materiale

Në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me dt. 28.04.2022 janë administruar provat materiale më sa vijon: *Një (1) CD, videoincizime nga vendi i ngjarjes; Raporti i hetuesit I.H #..., i përpiluar nën nr. të rastit: ....-DA-..., dt. 24.03.2021; Raporti i oficerit Z.A#..., i përpiluar nën nr. të rastit: ....-DA-..., dt. 24.03.2021; Raporti i oficerit V.Z, i përpiluar nën nr. të rastit: ....-DA-..., dt. 25.03.2021; Raporti i oficerit N.Z, i përpiluar nën nr. të rastit: ....-DA-..., dt. 24.03.2021; Raporti i hetuesit K.K, i përpiluar nën nr. të rastit: ....-DA-..., dt. 24.03.2021; Raporti i shpejtë, i përpiluar nën nr. të rastit: ....-DA-..., dt. 24.03.2021; Raporti i shpejtë shtesë, i përpiluar nën nr. të rastit: ....-DA-..., dt. 24.03.2021; Raporti mjekësor i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm – Emergjenca – Pejë, nën nr. ..., dt. 24.03.2021, në emër të të dëmtuarit A N; Raporti i hetuesit S.H, i përpiluar nën nr. të rastit: ....-DA-..., dt. 07.05.2021, lidhur me analizimin e videoincizimeve; Fletlëshimi me nr. ..., dt. 02.04.2021, i lëshuar nga QKUK – Prishtinë, në emër të të dëmtuarit A N; Fotografji mbi lëndimet e pësura nga i dëmtuari A N; Raporti i kqyrjes së vendit të ngjarjes, i përpiluar nën nr. .../., dt. 24.03.2021; Lista e dëshmimeve, e përpiluar nën nr. .../., ku është përshkruar gëzhoja e gjetur në vendngjarje; Fotoalbumi i vendit të ngjarjes; Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, i përpiluar nën nr. të rastit: ....-DA-..., në emër të L L; Lista e dëshmimeve, e përpiluar nën nr. TKRP-.../., ku edhe janë përshkruar të dhënat e armës së konfiskuar nga i pandehuri i rastit; Akt-ekspertimi mjeko-ligjor me nr. ref: PE-..., dt. 22.05.2021; Raporti i ekspertimit me nr. ref: AKF/...-.../...-..., dt. 16.06.2021; Fletlëshimi me nr. ..., dt. 16.07.2021, i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm – Reparti Kirurgjik – Pejë, në emër të të dëmtuarit A N; si dhe shkresat tjera të lëndës.*

### Mbrojtja e të pandheurit A N

Në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me dt. 28.04.2022 i pandehuri A N ka deklaruar se dëshiron të mbrohet në heshtje.

### Fjala përfundimtare e palëve

Prokurori i Shtetit fjalën përfundimtare ka përpiluar me shkrim dhe të njëjtën ka dorëzuar në kopje të mjaftueshme për të gjitha palët në procedurë duke potencuar se: sa i përket të pandehurit L L cili ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet ky pranim ka mbështetje në shkresat e lëndës dhe ka kërkuar që i njëjti të shpallet fajtor, të dënohet sipas ligjit, të obligohet në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale dhe po ashtu ti shqiptohet dënimi plotësues – konfiskimi i armës siç është propozuar në aktakuzë. Ndërsa sa i përket të pandehurit A N, për veprën penale “Sulm” nga neni 184 par. 1 të KPRK-së, pas administrimit të provave materiale dhe personale u vërtetua se i njëjti veprën penale ka kryer në dëm të të akuzuarit L L dhe këtë e mbështes edhe në deklaratat e dëshmitareve BC, M L, L dhe E N i, të cilët para gjykatës kanë dëshmuar se i njëjti ka përdorur forcën fizike duke e goditur me kokë të lartcekurin, e që një deklaram i dëshmitareve vërtetohet edhe me pamjet nga video incizimi i dt. 24.03.2021, ka kërkuar që deklaramit të tij mos ti falet besimi pasi që i njëjti është në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe ka propozuar që i njëjti të shpallet fajtor, të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale. Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin si rrethane lehtësuese gjykatës i ka propozuar që për të pandehurin L L ta merr pranimin e fajësisë në të gjitha fazat e procedurës penale dhe



sjelljen e tij korrekte gjatë në gjykatë, ndërsa si rrethane renduese shkallën e përgjegjësisë penale, intensitetin e rrezikimit me rastin e kryerjes se veprave penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale.

Mbrojtësi i të pandehurit LL, av. Taulant Broqi në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: Pasi që i mbrojturi i tij ka pranuar fajësinë për veprat penale i propozon gjykatës që si rrethane posaçërisht lehtësuese ta merr pranimin e fajësisë, gjithashtu si rrethanë tjetër lehtësuese te ketë parasysh faktin se natën kritike i mbrojturi i tij nuk e ka provokuar rastin, kjo dëshmohet edhe ne baze te provave se këtu i pandehuri tjetër me veturën e tij xhip është ndal ne parking, dhe i tha të mbrojturit të tij të afrohet dhe shihet qartë se nga xhipi janë dalë edhe dy persona tjera, si rrethane tjetër lehtësuese gjithashtu i mbrojturi i tij nuk ka ndonjë aktgjykim të formës së prerë që është dënuar ndonjëherë më pare, si rrethanë tjetër lehtësuese kërkon nga gjykata ta ketë parasysh edhe faktin se i mbrojturi i tij vet është dorëzua, e po ashtu dhe ka gjuajt vetëm një here ne drejtim te të pandehurit tjetër.

I pandehuri LL në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbështet fjalën përfundimtarë e mbrojtësit të tij dhe nuk ka çka të shtojë më shumë.

Mbrojtësja e të pandehurit A N, av. Majlinda Kollçaku me autorizim zëvendësues fjalën përfundimtare ka përpiluar me shkrim dhe të njëjtën ka dorëzuar në kopje të mjaftueshme për të gjitha palët në procedurë duke potencuar se: i mbrojturi i tij akuzohet për veprën penale “Sulm” nga neni 184 par. 1 të KPRK-së dhe kjo pike të aktakuzës bazohet vetëm në deklaratën e të pandehurit L të dhënë në Prokurori në cilësinë e të pandehurit. Dispozitivat e aktakuzës kane lidhshmëri njëra me tjetrën dhe me këtë kualifikim juridik të veprës së të pandehurit L duhet vërtetuar se a ka ekzistuar disproporcioni mes sulmit dhe zbrapsjes se sulmit, e që gjykata e bëri pranim e fajësisë pa e vërtetuar këtë rrethane kryesore për të pandehurin L. Potencon se organi i akuzës për ta lehtësuar pozitën e të pandehurit L në Procedure pa asnjë provë materiale bën zgjerimin e hetimeve edhe ndaj të mbrojturit të tij e që kinse ka ekzistuar sulmi paraprak nga i mbrojturi i tij. Ka propozuar që dëshmitares ML mos ti falet besimi pasi që e njëjta ka qenë kundërtënëse dhe kjo u vërtetua edhe me deklaratën e dëshmitares L B, ndërsa sa i përket dëshmitarit B C, i njëjti vërtetoi se për asnjë moment i mbrojturi i tij nuk e ka goditur me kokë të pandehurin L, dhe po ashtu kjo është vërtetuar edhe me deklaratën e dëshmitarit E. Po ashtu thekson se edhe nga incizimi shihet se jo që nuk ka pasur sulm nga i pandehuri A por nuk ka pasur as nevojë për zbrapsje të sulmit nga i pandehuri L dhe se e gjithë ngjarja zhvillohet pothuaj për 10 sekonda dhe pa u penguar fare nga brezi i pandehuri L nxjerr armën dhe shtie në momentin kur i pandehuri A dhe dëshmitaret ishin duke hyre në veture. Nga të gjitha këto, mbrojtësi është i bindur se trupi gjykues pas analizimit me kujdes të gjitha provave materiale, e sidomos video incizimit nga kamera e sigurisë do të bindet se i mbrojturi i tij nuk ka kryer asnjë veprim të sulmit dhe nuk e ka goditur të pandehurin tjetër me kokë dhe është i bindur se trupi gjykues ndaj tij do të bie aktgjykim lirues.

I pandehuri A N në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbështet fjalën përfundimtarë e mbrojtësit të tij dhe nuk ka çka të shtojë më shumë.

### **Vlerësimi i provave formale**

Nga raporti i hetuesit I.H #... dt. 24.03.2022 vërtetohet se i njëjti se bashku me hetuesit tjerë kishte dalur në vendin e ngjarjes e sipas informatave se aty ka ndodhur një plagosje me armë zjarri, ku në vendin e ngjarjes përball J.Gishin evidentuar disa gjurme të kuqe që dyshohet që është gjak dhe një gëzhoje nen një kombi-bus i cili ishte i parkuar në trotuar. Nga hetuesi tjetër

kishte pranuar informatën se bëhet fjale për viktimën A Q N i cili pas incidentit është dërguar në Spitalin Rajonal. Kanë kontaktuar pronarin e punëtorisë G.i cili nuk ka mundur për momentin ta sigurojë pamjet nga kamerat e sigurisë pasi që kishte probleme kohën e cila është e evidentuar në kamera me kohën reale. Sipas informatave i pandehuri ka qenë i shoqëruar me dy femra dhe pas rastit ka ikur. Vendi i ngjarjes është ekzaminuar nga krimi teknik B P. Është informuar se i dëmtuari është plagosur në anën e djathtë të barkut dhe është dërguar në QKUK në Prishtinë pasi që në Spitalin e Pejës nuk kanë mundur ta kryejnë intervenimin.

- Nga raporti i oficerit Z.A#... dt. 24.03.2021 vërtetohet se me dt. 24.03.2021 janë informuar për një rast të plagosjes në rr. P.K në Pejë dhe janë udhëzuar që të shkojnë në Spitalin e Pejës pasi që viktimë është dërguar në Emergjencë. Rrugës për spital kishin vërejtur një veturë xhip CH.ngjyre e hirit me targa ..-...-.. dhe të emergjencës nga e njëjta veturë dy persona e bartin të plagosurin e rastit të njëjtit. I njëjti kishte plage shpuese në bark dhe për momentin ishte jashtë rrezikut për jetë. I plagosuri quhet A N ndërsa me të ishin djali i tij E N dhe B C. Është informuar se rasti kishte ndodhur aty për aty përderisa ata ishin në veturë ndërsa personi tjetër ka qenë se bashku me dy femra duke ecur rrugës.
- Nga raporti i oficerit V.Z dt 25.03.2021 vërtetohet se është pranuar informata për një plagosje në afërsi të hotelit “J.” me dt. 24.03.2021 rreth orës 22:25 ku menjëherë kanë dalë në vendin e ngjarjes ku janë gjetur njolla të gjakut si dhe një gëzhoje. Vendi i ngjarjes është ekzaminuar nga forenzika e stacionit policor. Lidhur me këtë është intervistuar dëshmitari B C i cili ka përshkruar ngjarjen kritike.
- Nga raporti i oficerit N.Z dt. 24.03.2021 vërtetohet se pas pranimit të informatës për të shtëna me armë zjarri kanë dalur në vendin e ngjarjes ku kanë gjetur policin Kastriot Kasapi dhe kanë shkuar që ta kërkojnë të dyshuarin në drejtim të shkollës “8 M. pasi që dyshohet se i njëjti ka ik në atë drejtim. Të njëjtit kanë kërkuar edhe kamera në dy lokale dhe kanë vërejt një person që ka ik por nuk kanë mundur ta identifikojnë pasi që ka qenë shumë larg.
- Raporti i policit K.K dt. 24.03.2021 vërtetohet se pas pranimit të informatës për të shtëna me armë zjarri në rr. P.K në P. kanë dalur në vendin e ngjarjes ku kanë gjetur njolla gjaku si dhe një gëzhoje kalibër 25 auto. I njëjti raport ka të bëjë me veprimet hetimore siç janë marrja e informatave nga viktimë se kush ka qenë i dyshuari dhe po ashtu me kontaktimin e personit pronarit të elektro servisit në afërsi i cili ka pasur kamera të sigurisë mirëpo në atë moment nuk kanë mundur të verifikojnë se a kanë kapur kamerat momentin kritik.
- Raporti i shpejte me nr. të rastit ....-DA-.... dt. 24.03.2021 i njëjti ka të bëjë me informatat e para të pranuar në lidhje me këtë rast si me përshkrimin e ngjarjes nga ana e viktimës dhe dëshmitarit.
- Raporti i shpejte me nr. të rastit ....-DA-.... dt. 24.03.2021 ka të bëjë me punën hetimore me të cilën është identifikuar personi i dyshuar e që është L L mirëpo i njëjti nuk është arrestuar, respektivisht gjendet në arrati.
- Nga raporti mjekësor i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë – Reparti i Emergjencës nr. 2230 dt. 24.03.2021 vërtetohet se A N është pranuar në repartin e cekur dhe ka pranuar tretman mjekësor në lidhje me plagosjen që ka ndodhur.

- Nga raporti i hetuesit S.Hdt. 07.05.2021 nga i njëjti vërtetohet se janë tërhequr video incizimet dhe kanë vërtetuar se: në orën 23:48:20 xhip g. ch. vjen nga drejtimi i kundërt nga i pandehuri dhe në orën 23:48:30 parkohet në anën tjetër të rrugës. Në orën 23:48:38 vërehet i pandehuri i cili i vetum kalon rrugën nga drejtimi i hotelit “J.” dhe shkon në drejtim të xhipit. Në orën 23:48:50 shoferi i xhipit del prej veturës (por nuk mund të konstatohet se a ka goditur të pandehurin). Në orën 23:49 i pandehuri largohet nga xhipi mbrapa ku viktimja dhe një person tjetër i gjinisë mashkullore shkojnë në drejtim të të pandehurit, në këtë moment i dyshuari nga qanta e nxjerr pistoletën dhe shtie në viktimën të cilën edhe e qëllon dhe pas incidentit i njëjti largohet në këmbë nga veni i ngjarjes.
- Nga flete lëshimi me nr. 1824 dt. 02.04.2021 vërtetohet se A N ka qenë i hospitalizuar në QKUK në Prishtinë për trajtim mjekësor.
- Nga raporti i këqyrjes se vendit të ngjarjes i përpiluar nga Njësitë e Forenzikes me nr. të rastit ....-DA-... dt. 24.03.2021 vërtetohen veprimet e ndërmarra nga njësitë e hetimeve rajonale në Pejë, se bashku me njësitin e forenzikes ku ndër të tjera ceket se: vrasja e mbetur në tentative kishte ndodhur në rrugën P.K në Pejë, pikërisht buzë rrugës kryesore afër stacionit të trenit e që pikërisht ndodhej para firmës “SHPK A.”, ish depo e stacionit të trenit, dhe përball lokalit afarist “S.H.N.I”. Në anën e djathtë të rrugës e cila shpie nga rrethi i stacionit të trenit në drejtim të rrethit të ish OSCE-së. Buze rrugës vëreheshin gjurme gjaku dhe në trotuar nen një kombi u gjet një gëzhoje e armës së zjarrit. Nga këqyrja dhe ekzaminimi i vendit të ngjarjes gjendja faktike është fiksuar me anën e fotografimit dhe përshkrimit dhe gjurmët janë evidentuar si në vijim:
  - Dëshmia nr. #1 njolla gjaku,
  - Dëshmia nr. #2 njolla gjaku,
  - Dëshmia nr.#3 gëzhoje e kalibrit 25 auto, e cila u tërhoq nga vendi i ngjarjes dhe e njëjta është vendosur në dhomën e dëshmimeve për ekzaminim të mëtutjeshëm.
- Po ashtu janë bashkangjitur fotografitë të cilat pasqyrojnë gjendjen faktike.
- Nga lista e dëshmimeve me nr. të rastit ....-DA-... dt. 24.03.2021 vërtetohet se është gjetur dhe tërhequr dëshmia dhe atë një gëzhoje e kal. 25 auto në vendin e ngjarjes.
- Nga fotoalbumi i vendit të ngjarjes me nr. të rastit ....-DA-... me 14 fotografi në 8 faqe të formatit A4 vërtetohet pamja e përgjithshme e vendit të ngjarjes, përkatësisht vendi ku ka ndodhur incidenti si dhe janë fotografuar gjurmët e gjetura.
- Nga vërtetim mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve vërtetohet se nga L L janë sekuestruar përkohësisht sendet si në vijim: një pistolette Z. cal. 6x35mm me nr. serik .... dhe dy fishek kal. 6x35mm dhe një karikator i zbrazet.
- Nga foto albumi i përpiluar nen nr. TKRP-../.. janë përshkruar të dhënat e armës së konfiskuar nga i pandehuri i rastit.
- Nga Akt-Ekspertimi mjeko-ligjor nën nr. ref: PE-.., dt. 22.05.2021, rezulton se lëndimet e pësura nga i dëmtuari, bëjnë pjesë në **dëmtime të rënda trupore** dhe se ato

janë shkaktuar si rezultat i veprimit dinamik të predhës së hedhur nga armë e zjarrit.

- Nga Raporti i ekspertimit nën nr. ref: AKF/...-.../...-..., dt. 16.06.2020, nga çka ka rezultuar se gëzhoja e gjetur në vendin e ngjarjes, është shkrepur nga arma-pistoleta e dorëzuar nga i pandehuri i rastit, ndërsa që në anën tjetër nuk ka ndonjë përputhshmëri me librarinë e rasteve të hapura.
- Nga fletë lëshimi me nr. ... dt. 16.07.2021 i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë – Reparti Kirurgjik në emër të A N vërtetohet se i njëjti është pranuar në repartin kirurgjik për rikthim të cekostosmes.

***Të gjitha këto prova materiale kjo gjykatë i vlerësoje se janë të besueshme, të njëjtat janë siguruar në mënyrë ligjore nga organet publike.***

### **Analiza e provave dhe vlerësimi i fakteve**

Gjykata pas analizimit të të gjitha provave materiale dhe personale të cilët janë administruar gjatë këtij shqyrtimi kryesor gjyqësor ka ardhur në përfundim se:

#### **Faktet që nuk kanë qene kontestuese**

Nuk ka qene kontestues fakti se natën kritike i pandehuri Li shoqëruar me dy dëshmitare, L B dhe ML ka qene duke ecur në këmbë në trotuar.

Nuk ka qene kontestues fakti se përderisa i pandehuri L ka qene duke ecur me dy dëshmitare të lartcekura, aty me veturën e tyre kanë kaluar i pandehuri AN ku se bashku me të në veturë ishin edhe dëshmitaret B C dhe E N.

Nuk ka qene kontestues fakti se i pandehuri A N pasi ka kaluar vendin ku kanë qene duke ecur i pandehuri L L dhe dy dëshmitare tjerë, i njëjti është kthyer në rreth rrotullim dhe është kthyer te vendi ku ka qene i pandehuri L me dëshmitaret e lartcekura.

Nuk ka qene kontestues fakti se pasi që i pandehuri A N është kthyer nga rreth rrotullimi dhe është parkuar përballë vendit ku ka qene duke ecur i pandehuri L L, ky i fundit kishte kaluar rrugën dhe është afruar te vetura e të pandehurit A, dhe pas kësaj ka ndodhur edhe ngjarja kritike ku nga arma e zjarrit i pandehuri L ka plagosur të pandehurin A N, të cilin dëshmitaret BC dhe EN e dërgojnë ne spital për tretman mjekësor ndërsa i pandehuri L largohet me këmbë nga vendi i ngjarjes në drejtim të panjohur.

Nuk ka qene kontestues fakti se i pandehuri L L e ka plagosur të pandehurin A N me armen e zjarrit e markës Z. cal. 6x35mm me nr. serik ....., çka më pas edhe është vërtetuar me Raportin e ekspertimit nën nr. ref: AKF/...-.../...-..., dt. 16.06.2020, nga ku ka rezultuar se gëzhoja e gjetur në vendin e ngjarjes, është shkrepur nga arma-pistoleta e dorëzuar nga i pandehuri i rastit (e cila është sekuestruar nga i pandehuri L L, çka vërtetohet edhe me vërtetimin mbi sekuestrimin të përkohshëm të sendeve).

Të gjitha këto fakte janë vërtetuar edhe me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit L L për veprat penale të cilat i vihen në barrë.

### Faktet kontestuese

Për gjykatën kanë qenë kontestues faktet se si ka filluar ngjarja kritike mes të pandehurve L L dhe AN.

Për gjykatën ka qenë kontestues fakti se gjatë kalimit të të pandehurit A N me veturën e tij, afër trotuarit ku ka qenë duke ecur i pandehuri L L, a i është drejtuar me ndonjë fjale i pandehuri A N.

Po ashtu, për gjykatën ka qenë kontestues fakti se në momentin kur i pandehuri A N është kthyer me veturën e tij dhe është parkuar, a ka thirrur i njëjti të pandehurin L që të afrohet.

Në fund për gjykatën ka qenë kontestues fakti se në momentin kur i pandehuri L L është afruar tek vetura e të pandehurit A, a është sulmuar i njëjti nga ana e të pandehurit A.

### Gjendja e vërtetuar faktike.

Gjykata pas administrimit të të gjitha provave materiale dhe personale gjatë këtij shqyrtimi kryesor gjyqësor gjeti se është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitivat I dhe II të këtij aktgjykimi.

Se është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitivat e cekura si më lartë, kjo vërtetohet me:

Deklaratën e dëshmitares **L B** e cila përshkruan rastin dhe momentet kritike në mënyrë të njëjtë si në gjykate, ashtu edhe në deklaratën e saj e dhënë në Prokurori, dhe e cila nder të tjera ka deklaruar se i pandehuri A N fillimisht gjatë kalimit me veturën e tij i është drejtuar të pandehurit L me fjalët se “ama njonen” duke aluduar se i pandehuri L L ka qene duke ecur me dy femra, pastaj e njëjta deklaron se i pandehuri A ka vazhduar por është kthyer në rreth dhe ka parkuar veturën në anën tjetër të rrugës me çrast ka thirrur të pandehurin L që të afrohet. ***Po ashtu e njëjta sqaron se e kishte pare kur i pandehuri A fillimisht e kishte sulmuar fizikisht të pandehurin L***, ku më pas ka ndodhur ngjarja ashtu siç është përshkruar më lartë dhe për të cilën i pandehuri L L ka pranuar fajësinë.

Për këtë, e duke pasur parasysh se deklarata e dëshmitares LB është në përputhje të plote edhe me deklaratat e dëshmitareve tjerë e posaçërisht me deklaratën e dëshmitares ML si dhe me provat tjera të administruara, e po ashtu edhe me video incizimin e vendit të ngjarjes, gjykata deklarimit të saj ia falë besimin e plotë.

Me deklaratën e dëshmitares **M L** e cila përshkruan rastin dhe momentet kritike në mënyrë të njëjtë si në gjykate, ashtu edhe në deklaratën e saj e dhënë në Prokurori, dhe e cila nder të tjera ka deklaruar se i pandehuri A N fillimisht gjatë kalimit me veturën e tij i është drejtuar të pandehurit L me fjalët se “a po na jep një se e paske dy” duke aluduar se i pandehuri L L ka qene duke ecur me dy femra, pastaj e njëjta deklaron se i pandehuri A ka vazhduar por është kthyer në rreth dhe ka parkuar veturën në anën tjetër të rrugës me çrast ka thirrur të pandehurin L që të afrohet me fjalët se “hajde se kam punë me ty”. Po ashtu e njëjta sqaron se e kishte pare kur i pandehuri A menjëherë kur i pandehuri L është afruar, të njëjtin e ka goditur me kokë fillimisht e kishte sulmuar fizikisht të pandehurin L ku më pas ka ndodhur ngjarja ashtu siç është përshkruar më lartë dhe për të cilën i pandehuri L L ka pranuar fajësinë.

Për këtë, e duke pasur parasysh se deklarata e dëshmitares MLështë në përputhje të plote edhe me deklaratat e dëshmitareve tjerë e posaçërisht me deklaratën e dëshmitares L B si dhe me provat tjera të administruara, e po ashtu edhe me video incizimin e vendit të ngjarjes, gjykata deklarimit të saj ia fali besimin e plotë.

Me deklaratën e dëshmitarit **B C** cili ka deklaruar se i pandehuri A N i kishte thënë se i pandehuri L e ka sharë në momentin kur kanë kaluar afër tij, me veturën pastaj janë kthyer dhe e kane pyetur të njëjtin pse po shan, ku me rastin kur i pandehuri L është afruar tek vetura e tyre, i pandehuri A e ka shtyre. Mirëpo i njëjti deklaroi se në momentin kur ka shtënë me arme i pandehuri L, të njëjtit kane qene duke dashur të hyjnë ne veture, çka është në kundërshtim me provat tjera e posaçërisht me video incizimin e vendit të ngjarjes ku shihet se të tretë kanë nisur në drejtim të t ë pandehurit LL.

Gjykata këtij deklarimit të dëshmitarit B C i fali pjesërisht besimin pasi që deklarimet e të njëjtit nuk gjejnë mbështetje të plote në provat tjera të siguruara dhe të administruara, mirëpo ja fali besimin në atë pjese kur i njëjti ka deklaruar se i pandehuri Ae ka shtyre të pandehurin L.

Me deklaratën e dëshmitarit E N i cili ka deklaruar se i pandehuri A N i kishte thënë se i pandehuri L e ka sharë në momentin kur kanë kaluar afër tij me veturën pastaj janë kthyer dhe e kane pyetur të njëjtin pse po shan, ku me rastin kur i pandehuri L është afruar tek vetura e tyre, i pandehuri A e ka shtyre.

Gjykata këtij deklarimit të dëshmitarit E N i fali pjesërisht besimin pasi që deklarimet e të njëjtit nuk gjejnë mbështetje të plote në provat tjera të siguruara dhe të administruara, mirëpo ja fali besimin në atë pjese kur i njëjti ka deklaruar se i pandehuri A e ka shtyre të pandehurin L.

Gjykata po ashtu gjeti se gjendja faktike më se miri vërtetohet me video incizimin e vendit të ngjarjes ku rezulton kjo gjendje:

1. Incizim i emërtuar si ...., me kohëzgjatje prej: **23:47:35 – 23:49:16**.
  - **ora: 23:47:35** – momenti kur automjeti “J.C”, pronë e të pandehurit A N, vërehet se frenon gjersa është në lëvizje në drejtim të rrethrotullimit tek stacioni i trenit;
  - **ora: 23:47:55** – vërehet i pandehuri L L, nën shoqërimin edhe të dy dëshmitarëve M L dhe L B, gjersa ecin këmbë në drejtim të kundërt të automjetit, përkatësisht nga rrethotullimi tek stacioni i trenit, për në hotel “”;
  - **ora: 23:48:14** – momenti kur kthehet xhipi, dëshmitaret e përmendura presin tek tuneli i ndërtesës, ndërsa i pandehuri LL, vërehet tek kalon rrugën dhe shkon tek automjeti i të pandehurit A N;
  - **ora: 23:49:05 – 23:49:16** – paraqet pjesën kur i pandehuri L L, pasi të ketë shtënë me armë, kalon prapë rrugën dhe drejtohet për tek tuneli i ndërtesës, e që më pas edhe largohet në drejtim të panjohur;
2. Incizim i emërtuar si ...., me kohëzgjatje prej: **23:47:35 – 23:49:45**.
  - **ora: 23:47:35** – edhe këtu, por nga një kënd tjetër vërehet momenti kur automjeti “J.C”, pronë e të pandehurit A N, gjersa është në lëvizje në drejtim të rrethrotullimit tek stacioni i trenit;
  - **ora: 23:48:20** – vërehet kur automjeti në fjalë kthehet në drejtimin e kundërt, ndalon për një moment në shiritin e rrugës që qarkullon (element që arsyeton bisedën ndërmjet të pandehurve A N dhe L L), e pastaj parkohet në anën e djathtë të rrugës;

- **ora: 23:48:37** – momenti kur shfaqet i pandehuri L L dhe afrohet tek dera e shoferit të automjetit, pronë e A N;
- **ora: 23:48:46** – momenti kur nga automjeti dalin shoferi dhe pasagjeri nga ana e djathtë para. Në këtë çast, dy të pandehurit janë përballë njëri – tjetrit, ndërsa që pasagjeri shkon prapa të pandehurit LL;
- **ora: 23:48:51** – momenti kur i pandehuri L L bën një tërheqje të pavullneshme prapa, si rrjedhojë e shtyrjes dhe goditjes nga i pandehuri A N;
- **ora: 23:48:58** – momenti kur nga automjeti del edhe personi i tretë, nga dera e majtë prapa dhe që të tre (A N, B C, E) nisen në drejtim të të pandehurit L L;
- **ora: 23:49:00** – momenti kritik kur edhe i pandehuri L L dën një hap para dhe nga një distancë afërsisht dy metra, shtie në të dëmtuarin A N;
- **ora: 23:49:13 – 23:49:45** – në këtë interval kohor vërehet se pas momentit kritik, i pandehuri L L largohet, ndërsa i dëmtuari futet në automjet nga dëshmitarët B C dhe E N dhe shoqërohet për në spitalin e Pejës

Po ashtu, gjatë administrimit të provës materiale – CD me video incizimet nga vendi i ngjarjes, ne seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me dt. 28.04.2022 ku të pandehurit kanë deklaruar se:

I pandehuri L L e identifikon veten ne sekuencën e pamjes ne video, ne momentin kur e ka ftuar i akuzuari A dhe afrohet te vetura e tij, edhe ne pamjen ku nuk shihet mirë sqaron se shihen këmbët e tij dhe ne atë moment afër veturës kur i jam afruar shihen edhe 3 veta tjerë ku ne pamje shihen vetëm këmbët, mes tyre kam njoft vetëm A, dhe ne momentin kur jam goditur nga A jam tërhequr, sqaron se nga sekuenca shifet që të tre janë nisur ne drejtimin tim, për një moment shihet se i akuzuari L kthehet përballë tre personave, ata persona sipas tij ende nuk kane lëvizur por kane share dhe për këtë arsye është kthyer për ta pyetur se pse po shani, ata po vërehen se janë nisur ne drejtimin e tij dhe për një moment ka nxjerr revolen dhe ka shkrep ne drejtimin e tyre, sipas tij për shkak të frikës.

I pandehuri A deklaron: është e vërtetë që kjo vetura e cila po shihet se është ndaluar është vetura te cilën e kam drejtuar unë dhe është e vërtetë se unë jam kthyer me veturën time, kam pyetur se pse me ka sharë, ne këto pamje po identifikoj se kam dal nga vetura, ka ardh personi nga ana e kundërt, e kam pyetur se pse po shan, ne momentin kur me është afruar e kam kap për duart dhe e kam shty dhe i kam thënë hajt shko të shpija, dhe ne atë moment kur e kam shty e kane dalur edhe ato persona tjera siç po shihet, dhe siç po vërehet shihet se ai ka nis me shku dhe ne një moment është kthyer kur ne kemi dashtë me hi ne veture.

Andaj, duke pasur parasysh të gjitha provat personale dhe materiale të administruara dhe po ashtu duke pasur parasysh edhe faktet jokontestuese dhe ata kontestuese të cilët janë sqaruar gjatë shqyrtimit kryesor, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

*Se i pandehuri L L natën kritikë ka qene duke ecur rrugës me dy dëshmitaret e rastit, M L dhe L B, po ashtu në atë rrugë me veturën e tij xhip G.CHka kaluar i pandehuri A Ni i cili ka drejtuar atë veture dhe me të ishin dëshmitaret B C dhe E N. Të njëjtit e kanë pasur një konflikt verbal të atëçastshëm, i pandehuri A ka vazhduar rrugës mirëpo është kthyer në rreth rrotullim në afërsi dhe është parkuar në krahun tjetër të rrugës, me çrast e ka ftuar të pandehurin L që të afrohet. Kur i pandehuri L është afruar tek vetura e të pandehurit A, ky i fundit fillimisht e godet me kokë në kokë të pandehurin L dhe e kap për dore dhe e shtyen, siç edhe është përshkruar në dispozitivin I të këtij aktgjykimi, ku pas kësaj i pandehuri L L kthehet 3-4 metra*

*mbrapa dhe ne momentin kur i pandehuri A dhe deshmitaret B dhe E nisen në drejtim të të pandehurit L, në atë moment ky i fundit nga çanta e tij e krahut e nxjerr revolen e tipit "Z.", kalibër ..., me nr. serik: ...(të cilën ka mbajtur në kundërshtim me ligjin siç është përshkruar në dispozitivin II pika b) dhe me të njëjtën, nga një distancë afërsisht dy metra, shtie njëherë në drejtim të të dëmtuarit A N, duke e goditur atë në pjesën e barkut dhe duke i shkaktuar kështu lëndime të rënda trupore, për çka më pastaj ka pranuar tretman mjekësor.*

### **Vlerësimi juridik i çështjes**

Nga gjendja e fakteve të vërtetuara si dhe me provat e administruara personale dhe materiale-formale, gjatë këtij shqyrtimit kryesor, gjykata ka ardhur në përfundim se i pandehuri A N me veprimet e tij është inkriminuar në figurën e veprës penale "Sulm" nga neni 184 par. 1 të KPRK-së të përshkruar si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi. Gjukata ka ardhur në përfundim se pa mëdyshje janë konstatuar veprimet e të pandehurit e që janë përdorimi i forcës ndaj personit tjetër pa pëlqimin e personit tjetër, dhe atë në atë moment kur i njëjti është konfrontuar fizikisht me të pandehurin L L duke e goditur me kokë në kokë dhe duke e shtyre.

Duke vendosur lidhur me përgjegjësinë penale të të akuzuarit A N për veprimet e kryera që kanë të bëjnë me përdorimin e forcës ndaj personit tjetër pa pëlqimin e tij, gjykata bindjen e krijoj me dëgjimin e dëshmitareve të cilët kanë qenë prezentë në vendin e ngjarjes dhe atë L B dhe ML si dhe B C dhe E N. Po ashtu gjykata bindjen edhe më të madhe e krijoj me rastin e analizimit të video incizimit të ngjarjes kritike e nxjerrur nga kamerat e sigurisë, e duke pasur parasysh faktet qenësore të vërtetuara si me lartë, ka ardhur në përfundim, jashtë çdo dyshimi, se vepra penale e Sulmit nga i akuzuari A N është kryer si është përshkruar në dispozitiv I të këtij aktgjykimi.

Sa i përket fajësisë, gjykata ka gjetur se te i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryej në mënyrë e përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e kryera dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Ne rastin konkret, gjykata nuk ka gjetur asnjë rrethanë që do të ishte me ndikim për zvogëlimin apo përjashtimin e përgjegjësisë penale të akuzuarit A N, prandaj i njëjti shpallet fajtor për veprën penale nga dispozitivi I i këtij aktgjykimi.

Po ashtu, me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit L L është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv II pika a dhe b të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale "Vrasje e mbetur në tentativa në rrethana të tejkalimit të mbrojtjes së nevojshme" nga neni 172 e lidhur me nenin 28 dhe nenin 12 par. 3 të KPRK-së dhe veprën penale "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve" nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Po ashtu gjykata ka gjetur se i pandehuri L L ka vepruar në rrethana të tejkalimit të mbrojtjes së nevojshme, pasi që i njëjti paraprakisht është sulmuar nga i pandehuri A siç është përshkruar në dispozitivin I, mirëpo i njëjti duke vepruar në zmbropsjen e sulmit i cili ka qenë i kundërligjshëm, real dhe i atëçastshëm, ka tejkaluar kufijtë e mbrojtjes së nevojshme.

Gjukata nuk ka gjetur asnjë rrethanë që do të ishte me ndikim për zvogëlimin apo përjashtimin e përgjegjësisë penale të akuzuarit L L, prandaj i njëjti shpallet fajtor për veprën penale nga dispozitivi II pika a dhe b të këtij aktgjykimi.



## **Vendimi mbi dënimet**

Para se të vendoset mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat kishin me ndiku në llojin dhe lartësinë e dënimit të parapare nga neni 69 dhe 70 tI KPRK-së për të akuzuarit A N dhe L Le të cilat gjykata i ka vërtetuar gjatë shqyrtimit kryesor gjyqësor.

Gjykata për të pandehurin A N në rastin konkret rrethana lehtësuese nuk gjeti, ndërsa nga rrethanat rënduese gjeti se shkallen e lartë të dashjes për faktin se i njëjti ka qenë provokuesi i rastit të ndodhur ditën kritike pas parasysh se i njëjti prej fillimit e ka nxitur ndodhjen e rastit me veprimet e tij siç janë fillimisht duke ju drejtuar të pandehurit L L me fjale provokuese nga vetura në lëvizje që ishte duke e drejtuar, pastaj me kthimin e serishëm edhe pse kishte kaluar vendin ku i pandehuri L ka qenë duke ecur me këmbë me dy dëshmitaret, pastaj me thirrjen e të pandehurit L që të afrohet tek vetura e tij, gjë që L ishte afruar dhe me të afruar, të njëjtin e kishte sulmuar duke e goditur me kokë në kokë, gjë që edhe këtë veprim të tij e kanë konfirmuar edhe dëshmitaret e rastit, e të cilat veprime në fund kanë shtyre të pandehurin L që ta veprojë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Si rrethanë tjetër rënduese për të pandehurin A N, gjykata gjeti moshën e rë të viktimës () i cili posa ka mbushur 18 vjet, dhe po ashtu ka qenë i ri në raport me të pandehurin A dhe atë për më shumë se njëzetë vjet.

Gjykata për të pandehurin L L në rastin konkret nga rrethana lehtësuese gjeti se i njëjti ka pranuar fajësinë në të gjitha fazat e procedurës penale, ka pasur sjellje korrekte gjatë gjykimit, ndërsa nga rrethanat rënduese gjeti shkallen e përgjegjësisë penale, intensitetin e rrezikimit me rastin e kryerjes se veprave penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimet e shqiptuara të pandehurve janë në përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënimet e shqiptuara do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit, në pengimin e të pandehurve në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, dhe po ashtu do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale, si dhe ta shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit në përputhje me nenin 38 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 42 e lidhur me nenin 184 par. 1 të KPRK-së, të pandehurit AN i shqiptoi dënimin me burgim si në piken I të këtij aktgjykimi.

Gjykata konform nenit 42 e lidhur me nenin 172, nenin 28 dhe nenin 12 par. 3 të KPRK-së, të pandehurit L L i shqiptoi dënimin me burgim si në piken II të këtij aktgjykimi e në të cilin dënim konform nenit 79 par. 1 të KPRK-së ka për tu llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim dhe atë nga dt. 06.05.2021 e deri me dt. 29.04.2022.

Gjykata konform nenit 43 e lidhur me nenin 366 par. 1, të KPRK-së, të pandehurit L L, i shqiptoi dënimin me gjobë si në piken III, të këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri L L nuk dëshiron, apo refuzon ta paguaje dënimin me gjobë të shqiptuar si në piken III të këtij aktgjykimi, i njëjti konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së do ti zëvendësohet në dënim burgimi duke i llogaritur shumen prej 20 euro për një dite burgimi.

I pandehuri L L në kuptim të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPPRK-së është obliguar në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale, si dhe konform nenit 39 par. 1, 2, 3 nën par 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit i njëjti është obliguar në paguarjen e taksës për kompensimin e viktimave të krimit, në shumën si në piken V të këtij aktgjykimi.

I pandehuri A N konform nenit 453 par. 4, të KPPRK-së, lirohet nga paguarja e shpenzimeve të procedurës penale si në piken VI të aktgjykimit, pasi që i njëjti është veteran i luftës dhe këtë ka dëshmuar me kartelën e veteranit e cila gjendet në shkresat e lëndës.

Konform nenit 367 par. 1 pika 1.2 të KPPRK-së të pandehurit L L i është ndërprere masa e paraburgimit pas shpalljes se këtij aktgjykimi, dhe për këtë është marrë aktvendim i veçantë me dt. 29.04.2022.

Konform nenit 366 par. 3 të KPRK-së të pandehurit L L i është shqiptuar dënimi plotësues – marrja e sendit, konfiskimi i armës si në piken VIII të këtij aktgjykimi, e cila pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit ka për tu shkatërruar.

Palët e dëmtuara, njëkohësisht të pandehurit, për realizimin e kërkesave eventuale pasurore juridike, reciprokisht, konform nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, udhëzohen në kontest të rregullt civil.

Në lidhje me përpilimin e aktgjykimit të shkruar është kërkuar shtyrje e afatit të përpilimit edhe për një afat shtesë prej 30 (tredhjet) ditësh nga ana e kryetarit të Gjykatës, ngase pas shpalljes se aktgjykimit me dt. 29.04.2022, me Aktvendimin PKR.Nr.155/21, të pandehurit L Li është ndërprerë masa e paraburgimit deri në plotfuqishmërinë e Aktgjykimit, përderisa ndaj Aktvendimit mbi ndërprerjen e masës së paraburgimit Prokurorja e shtetit përmes kësaj gjykate ka ushtruar ankesë në gjykatën e Apelit, në lidhje me ndërprerje ashtu që për shkak të vonesës së kthimit me dt. 31.05.2022, jemi detyrua me dt.01.06.2022 kemi parashtrua kërkesë për shtyrje të përpilimit të aktgjykimit e cila kërkesë ka gjete mirëkuptimin e arsyeshmërisë dhe si e tillë është aprovuar nga Kryetari i gjykatës gjerë me dt.04.07.2022<sup>1</sup>.

Nga sa u tha me lartë, e konform nenit 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**  
**PKR.nr.151/21 më datë 30.06.2022**

**Zyrtari ligjor**

**Gj y q t a r i,**

---

**Alan Taranish**

---

**Dr.sc. Murat Hulaj**

**KESHILLA JURIDIKE;**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.

---

<sup>1</sup> Njoftimi mbi aprovimin e shtyrjes PKR.nr.151 i dt. 01.06.2022, nga kryetari i gjykatës.

Numri i lëndës: 2021:081494  
Datë: 01.07.2022  
Numri i dokumentit: 03193998